# Gugash Magani: Mbijetesen dhe Kupen e Shqiperise

nga AlbaniaSoccer
E martë, 03 Dhjetor 2013 22:52

Trajneri i ri i Tiranes Gugash Magani pa frike ka deklaruar se skuadra e tij ka mundesi te mbijetoje dhe te fitoje gjithashtu Kupen e Shqiperise. "Duke pare renditjen, per ne primar do te jete kampionati sepse jemi ne vend te fundit. Ndeshja e kupes eshte shume e rendesishme sepse Tirana e ka detyrim te luaje ne te dyja kompeticionet dhe tiu shkoj gjerave deri ne fund. Lushnja eshte nje ekip shume i forte sidomos ne fushen e vet, gje qe e tregoi edhe kete fundjave. Formacioni? Po ju them vetem qe nuk do kete shume ndryshime, pasi nuk eshte momenti por ne do te luajme me dy sulmues. Kushti qe pranova te merrja drejtimin e bardhebluve ishte sepse mu dha garancia qe ne merkaton e janarit do te afrojme lojtare cilesore ne ekip, megjithate une besoj tek skuadra qe kam", ka deklaruar Magani.